

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sulmi ndaj Iris Luarasit dhe Ilva Gjuzit, reagojnë deputetet socialiste: Dhuna është dhunë dhe duhet trajtuar njësoj nga institucionet – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/sulmi-ndaj-iris-luarasit-dhe-ilva-gjuzit-reagojne-deputetet-socialiste-dhuna-eshte-dhune-dhe-duhet-trajtuar-njesoj-nga-institucionet/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 14:40:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 14:36:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	857adccc9688c99768db0edf5c739d11d0a36cfdff3231d6aa20a539490317de
TEKSTI	712377052210fcacc3081184eba0eb8a0c04c2e2634769785d7ea773870e4add
PAMJA	abe2388ccb95f7a8fc38f0be3c1a9ae7ba8fc4748b8e95e4782a2d6e3e9c3104

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	738ef6ce0b92c010fe63270f2bb037c1408625d0339aec4835c5fae8fdad0258
E MËPARSHMJA	e2d5e7c099998013b2cec5d86f1eafe5743a5c536cae697354768675e7ffe3da
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/738ef6ce0b92c010fe63270f2bb037c1408625d0339aec4835c5fae8fdad0258>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Gratë deputete të grupit parlamentar të Partisë Socialiste kanë reaguar në lidhje me incidentin e një dite më parë, ku deputetja Iris Luarasi u dhunua verbalisht nga disa protestuese, ndërsa po i drejtohej Kuvendit, ndërsa deputetja tjetër, Ilva Gjuzi, u sulmua me vezë dhe sende të forta, ndërsa po largohej me makinë.

Në deklaratën e tyre, gratë socialiste dënojnë me forcën më të madhe sulmet verbale, kërcënimet, fyerjet dhe aktet e agresionit fizik të ushtruara nga një pjesë e dhunshme e protestuesve ndaj deputetëve gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tyre.

Gratë deputete i janë drejtuar institucioneve ligjzbatuese që ta çojnë deri në fund çështjen dhe të vënë para përgjegjësisë dhe ligjit dhunueset.

Deklaratë e grave deputete të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste:

Gratë deputete të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dënojnë me forcën më të madhe sulmet verbale, kërcënimet, fyerjet dhe aktet e agresionit fizik të ushtruara nga një pjesë e dhunshme e protestuesve ndaj deputetëve gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës së tyre.

Ngjarjet e fundit ndaj deputeteve Iris Luarasi dhe Ilva Gjuzi nuk janë incidente të izoluar. Ato janë pjesë e një klime të përsëritur dhe të zgjatur lincimi publik, intimidimi dhe agresioni, që po kalon nga diuba e urreitjes të

5 Elbasani nuk ranë egnatia peson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

kontakti fizik. Sot u ndodh atyre. Nesër mund t'i ndodhë çdo deputeti, gazetari, punonjësi publik apo qytetari që refuzon t'i nënshtrohet presionit të turmës.

Para se të jemi deputetë, jemi qytetarë. Kemi të njëjtën të drejtë si çdo qytetar tjetër për të lëvizur të sigurt, për të ushtruar detyrën dhe për të mos u fyer, kërcënuar, ndjekur apo sulmuar. Këto akte nuk po ndodhin vetëm pranë Kuvendit, por edhe në hapësira të tjera publike dhe private.

Nuk kërkojmë privilegje. Kërkojmë respektimin e të drejtave themelore që Kushtetuta dhe ligji ia garantojnë çdo qytetari.

E drejta për të protestuar është e patjetërsueshme. Kritika politike, kundërshtimi dhe zemërimi qytetar janë pjesë e demokracisë. Por protesta nuk është licencë për të fyer, kërcënuar, ndjekur apo goditur. Telefoni i ngritur për të filmuar nuk e shndërron agresionin në aktivizëm. Turma nuk e bën dhunën të ligjshme.

Refuzojmë çdo përpjekje për relativizim. Nuk ka "por" pas një sulmi. Nuk ka rëndësi nëse agresori është burrë apo grua, nëse mban një pankartë apo një celular, nëse sulmon një deputet të mazhorancës apo të opozitës.

Dhuna është dhunë dhe duhet trajtuar njësoj nga institucionet.

Kur një deputet sulmohet gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, nuk cenohet vetëm individi. Cenohet funksionimi i lirë i mandatit përfaqësues, siguria e Kuvendit dhe vetë rendi demokratik. Asnjë deputet nuk duhet të hyjë në Kuvend nën një korridor fyerjesh dhe agresioni, duke pyetur veten nëse goditja e radhës do të jetë vetëm verbale apo edhe fizike.

Për këtë arsye, kërkojmë:

* Nga Policia e Shtetit: identifikimin e menjëhershëm të personave të përfshirë, administrimin e plotë të pamjeve dhe referimin pa vonesë të çdo veprimi të paligjshëm.

* Nga organet e drejtësisë: hetim të shpejtë, të paanshëm dhe individualizim të përgjegjësive për çdo person të përfshirë.

* Nga strukturat përgjegjëse për sigurinë e Kuvendit: rishikim urgjent të protokolleve për mbrojtjen e deputetëve gjatë hyrjes, daljes dhe ushtrimit të detyrës.

* Nga drejtuesit dhe organizatorët e protestave: distancim të qartë dhe publik nga çdo akt dhune, intimidimi dhe linçimi.

* Nga të gjitha forcat politike dhe mediat: të mos justifikojnë dhunën sipas përkatësisë politike të viktimës ose agresorit.

* I bëjmë thirrje shoqërisë civile, organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht atyre që punojnë për të drejtat e grave, të reagojnë pa standarde të dyfishta ndaj dhunës verbale, linçimit publik dhe intimidimit të grave deputete duke ruajtur standartin demokratik. Mbrojtja e grave nuk mund të varet nga funksioni, bindjet apo përkatësia e tyre politike. Heshtja përballë dhunës, vetëm sepse viktima është grua në politikë, e normalizon dhe e inkurajon atë. Të drejtat e grave ose mbrohen për çdo grua, ose shndërrohen në një slogan selektiv.

Kërkojmë që brenda 72 orëve Policia e Shtetit dhe strukturat përgjegjëse të

informojne zyrtarisht kuvendin per masat e marra dhe planin e sigurise.

Brenda 10 ditëve, kërkojmë një raport të plotë mbi identifikimin e përgjegjësve, ecurinë e referimeve dhe masat parandaluese.

Nuk do të pranojmë që heshtja institucionale ta ushqejë pandëshkueshmërinë. Nuk do të lejojmë që dhuna të normalizohet si “folklor proteste” dhe as që poshtërimi publik të shitet si pjesëmarrje qytetare.

Demokracia mbrohet me fjalë, argumente dhe votë. Aty ku fillon dhuna, mbaron protesta. Dhe aty duhet të fillojë përgjegjësia.

#Dhuna

#gratesocialiste

#VizionPlus



Taulant Halili

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

POLITIKË

Begaj uron nisjen e vitit të ri shkollor...

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë

POLITIKË

“Nuk po na lejohet të marrim nga qesja...

Xhuljana Zhuleku · Dje 21:49

POLITIKË

“Të dëgjojmë dhe të trajtojmë çdo...

Xhuljana Zhuleku · Dje 20:03



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.